



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.01, datë 04.06.2024

**PËR**  
**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:**  
**“KOMPLEKS TURISTIK, REZIDENCIAL DHE SHËRBIME (NUKLI 1)”, ME**  
**VENDNDODHJE NË JALË, BASHKIA HIMARË**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqëritë “Soleil & Sea” sh.p.k, “VIKI” sh.p.k dhe “ECW” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Kompleks turistik, rezidencial dhe shërbime (Nukli 1)”, me vendndodhje në Jalë, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues shoqëritë “Soleil & Sea” sh.p.k, “VIKI” sh.p.k dhe “ECW” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhen si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Himarë.
4. Vendimi i Këshillit Kombëtar i Territorit Nr. 24, datë 16.03.2022 “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Kompleks turistik, rezidencial dhe shërbime”, me vendndodhje në Jalë, Bashkia Himarë” dhe Vendimi i Këshillit Kombëtar i Territorit Nr. 25, datë 16.03.2022 “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Kompleks turistik, rezidencial dhe shërbime”, Faza 1, me vendndodhje në Jalë, Bashkia Himarë”, shfuqizohen.

SHILLI I MINISTRAT

Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

**KRYETARI**  
**EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT  
MIRELA KUMBARO FUXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 23/09/2024